

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, koleji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Mustafa, kryetare, Avdi Dinaj dhe Valdete Daka, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Qefsere Berisha, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarve B. K. dhe B. B. për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës zyrtare, nga neni 242 par. 1 të KPK dhe marrja e ryshfetit nga neni 343 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPK, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit B. K., E. K., av. nga Prishtina, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë-Departamenti për krime të rënda PKR.nr.104/2014 datë 24.7.2015, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit – Departamenti për krime të rënda, PAKR.nr.415/2015 datë 13.11.2015, në seancën e kolegjit të mbjatur më 29 shkurt 2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit B. K., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë-Departamenti për krime të rënda, PKR.nr.104/2014 datë 24.7.2015, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit – Departamenti për krime të rënda, PAKR.nr.415/2015 datë 13.11.2015.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore –Departamenti për krime të rënda Gjakovë, PKR.nr.104/2014 datë 24.7.2015, i dënuari B. K. është shpallur fajtor për veprën penale marrja e ryshfetit nga neni 343 par. 1 të KPK dhe për këtë vepër penale është gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 6(gjashtë) muajsh, në të cilin do t'i llogaritet koha e kaluar në arrest shtëpiak prej 23.4.2014 gjer më 22.5.2014. Është detyruar që të dëmtuarit S. O. t'ia kthejë shumën prej 1.000 €, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Është detyruar i dënuari që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës dhe 100 € në emër të shumës paushalle.

Me të njëjtin aktgjykim i akuzuari B. B. është liruar nga akuza për shkak të veprave penale keqpërdorimi i detyrës zyrtare nga neni 422 par. 1 të KPK dhe marrja e ryshfetit nga neni 343 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPK-së.

Ky aktgjykim është vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës së apelit –Departamenti për krime të rënda Prishtinë PAKR.nr.415/2015 datë 13.11.2015.

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit B. K., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së Ligjit penal, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen , i dënuari të lirohet nga akuza apo të anulohet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje apo dënimi me burgim t'i zëvendësohet në dënimin me gjobë.

Prokuroi i Shtetit të Kosovës me parashtresën KMLP.II.nr.24/2016 datë 10.2.2016 ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit i shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes konform dispozitës së nenit 435 të KPPK-së, vlerësoi thëniet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe gjeti se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Në kërkesën e ushtruar nga mbrojtësi i të dënuarit B. K., E. K. theksohet se aktgjykimet e kundërshtuara bazohen mbi bazën e provave të papranueshme për faktin se deklarata e dëshmitarit A. B. është lexuar në shqyrtimin gjyqësor edhe pse e njëjta është dhënë në organet policore kështu që konform dispozitës së nenit 262 aktgjykimet e kundërshtuara nuk mund të mbështeten vetëm në një provë të vetme të këtij dëshmitari. Po ashtu thekson se gjykatat aktgjykimet e kundërshtuara i bazojnë edhe në një CD edhe pse kanë refuzuar propozimin e të dëmtuarit që CD të administrohet si provë, por edhe përkundër kësaj aktgjykimi i kundërshtuar i shkallës së dytë, bazohet në këtë provë kur thekson se paska pasur një CD mbi vizitat e të dënuarit tek fëmija adoptues edhe pse këto vizita janë të lejueshme.

Konsideron se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 pika 12 lidhur me nenin 370 par. 7 dhe 8 të KPPK-së për faktin se aktgjykimet e kundërshtuara janë në kundërshtim me vetveten, sepse diapozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë është i paqartë, në kundërshtim me arsyetimin, në arsyetim nuk janë paraqitur arsyet bindëse që i dëmtuari të deklarohet fajtor, ngase vetëm përsëriten deklaratat e dëshmitarëve të dëgjuar ndërsa me asnjë provë nuk vërtetohet faktin e marrjes së rryshfetit.

Përkritazi me shkeljen e Ligjit penal në kërkesë mbrojtësi thekson se me rastin e shqiptimit të dënimit është dashur të konstatohet se cilat ishin rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese që kanë ndikuar në shqiptimin e dënimit, e të cilat nga gjykata e shkallës së parë nuk janë arsyetuar fare. Po ashtu thekson se gjykata e shkallës së dytë nuk është sqaruar se në cilën fazë të procedurës i dënuari mund të japë pëlqimin për zëvendësimin e dënimit me burg në dënimin me gjobë, duke konsideruar se gjykatat kanë shkelur dispozitën e nenit 47 të KPPK-së.

Gjykata Supreme vlerëson se pretendimet e cekura në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë kanë qenë të theksuara edhe në ankesën e ushtruar nga mbrojtësi i të dënuarit kundër aktgjykimit të shkallës së parë, por gjen se këto pretendime janë të pabazuara nga këto arsye:

Në mbështetje të provave të administruara në këtë çështje penale, gjykata e shkallës së parë me pa mëdyshje ka vërtetuar rrethanën se meqë i dëmtuari S. O. nga bashkësia martesore nuk ka pasur fëmijë, në Qendrën për punë sociale në Ferizaj, ka bërë kërkesë për adoptimin e një

fëmije të gjinisë mashkullore. Qendra për punë sociale këtë kërkesë e ka shpërndarë nëpër të gjitha qendrat për punë sociale në Kosovë për faktin se kjo Qendër nuk ka pasur fëmijë për adoptim. Në ndërkohë kjo Qendër informohet se në Komunën e Malishevës një fëmijë ka qenë i strehuar në familjen strehuese D., në Komuna e Drenasit. Meqë i dënuari B. K. pa i njoftuar familjes strehuese, ka shkuar në këtë familje për ta vizituar fëmijën A. Z. me ç'rast kjo familje strehuese ka pasur rast vdekje por, edhe përkundër këtij fakti ia kanë mundësuar vizitën e fëmijës. Nuk është kontestuese se i dëmtuari ka qenë me bashkëshorten dhe se me rastin e vizitës fëmija i ka pëlqyer. I dënuari i pyet familjen e të dëmtuarit se a keni dëshirë sërish ta vizitoni fëmijën, e meqë i përgjigjen pozitivisht i dënuari u tregon se duhet filluar procedura e rregullt e adoptimit.

Nga provat e administruara vërtetohet se me 1.3.2012 i dënuari së bashku me mikun e tij A. B. -me automjetin e tij ka shkuar në Malishevë, në Qendrën për punë sociale e ftojne të dënuarin me ç'rast së bashku shkojnë në familjen strehuese, ndërsa në rastin e kthimit në një parking afër Qendrës për punë sociale, i dënuari i kërkon të dëmtuarit shumën e të hollave prej 1.000 €, të cilat duhet ndarë me drejtorin B. B., si dhe për faktin se edhe në gjykatë duhet dhënë një sasi të hollash në prezencën e dëshmitarit A. B.. Po ashtu i dënuari me këtë rast i thotë të dëmtuarit se pas përfundimit të procedurës së adoptimit, duhet dhënë të hollat prej 8.000 gjer në 10.000 €, me çka i dëmtuari S. i përgjigjet – se nuk po blej fëmijë me pare dhe nga këto arsye, sipas të dëmtuarit e refuzojnë adoptimin duke i thënë se nuk i takon adoptimi i fëmijës meqë është shtetas i Gjermanisë.

Nuk janë kontestuese rrethanat se pranë Gjykatës Themelore në Ferizaj është zhvilluar procedura për adoptim ku përfaqësuesi i Qendrës për punë sociale ishte i dënuari B. K. dhe se në të gjitha instancat gjyqësore është marrë vendimi gjyqësor me ç'rast kërkesa për adoptim është refuzuar.

Këtë gjendje faktike gjykatat e kanë vërtetuar në bazë të provave të administruara nga gjykata e shkallës së parë kështu që nga dëshmia e dëshmitares F. S., e cila si zyrtare ka konstatuar se familja e të dëmtuarit jeton në Gjermani dhe se duhet t'u nënshtrohet procedurave për adoptim me element ndërkombëtar, që nënkupton se personi që jeton jashtë vendit duhet të vlerësuar përshtatshmëria e tyre për adoptim në shtetin ku jeton. Sipas kësaj dëshmitareje është vërtetuar se paneli shtatë anëtarësh i ka rekomanduar Qendrës për punë sociale – punëtorit social

B. K. t'i ndjekë procedurat me vërejtje për lëshimet e bëra ndërsa vizitat e realizuara janë të paligjshme ngase familja O. nuk ka pasur vendim gjyqësor për caktimin e periudhës provuese ndërsa zyrtarëve për këto shkelje iu është dhënë vërejtja profesionale për lëshimet e bëra. Sipas M. D., e cila ka qenë familja strehuese, sipas vendimit të Qendrës për punë sociale në Malishevë për fëmijën A. Z., i cili ka qenëduar për 22 muaj, familja O. ka bërë vizitë çdo muaj përmes punëtorit social-të dënuarit B. K..

Vlen të theksohet se përveç të dëmtuarit S. O., i cili vërteton se të dëmtuarit i ka dhënë të holla edhe dëshmitari A. B., i cili është dëgjuar në cilësinë e dëshmitarit, në prezencën e mbrojtësit të dënuarit në Prokurorinë Themelore, vërteton rrethanat se me 1.3.2012 pasi marrin të dënuarin B. në Qendrën për punë sociale në Malishevë, me rastin e kthimit nga familja strehuese, i dënuari B. i kërkon të hollat të dëmtuarit S., i cili i jep 1.000 € të dënuarit B. i cili dhe i fut ato në xhep të këmishës. Rrethanat e vizitave të bashkëshortëve O. me dëshmitarin A. B. nuk i konteston as vet i dënuari përveç rrethanës se kërkesës dhe të dhënies së të hollave nga i dëmtuari.

Nga këto rrethana qëndron fakti se aktgjykimet e kundërshtuara mbështeten edhe në deponimet e të dëmtuarit S. O., por kjo nuk është provë e vetme dhe e izoluar ngase përveç provave tjera të administruara, aktgjykimet e kundërshtuara mbështeten edhe në deponimet e dëshmitari A. B. të dhëna në hetuesi, në Prokurorinë Themelore në prezencën e mbrojtësit të dënuarit Q. J., e cila deklaratë në hetuesi ka mundur të kundërshtohet nga mbrojtësi i të dënuarit. Andaj, pretendimet e mbrojtësit të dënuarit në kërkesë se aktgjykimet e kundërshtuara mbështeten në prova të papranueshme si dhe pretendimet se gjykatat kanë vepruar në kundërshtim me dispozitën e nenit 262 të KPPK-së, janë të pabaza. Prandaj, në mbështetje të gjithë kësaj që u tha më lartë, edhe sipas të kësaj Gjykate, rezulton se përfundimet e gjykatave janë të bazuara në provat e administruara, e në gjithë këtë situatë i dënuari me dashje dhe në kuadër të veprimeve konkrete ka realizuar përfitim material, që në kuadër të autorizimeve si punëtor social në Qendrën për punë sociale në Malishevë. Në mbështetje të provave të administruara nuk vihet në dilemë ndërmartja e veprimeve inkriminuese ngase si në dispozitiv e po ashtu edhe në arsyetimet e aktgjykimëve të kundërshtuara, qartë sqarohen rrethanat nën të cilat vepra është kryer.

Sa i përket pretendimeve që dënimi i shqiptuar me burgim i zëvendësohet me dënim me gjobë, vlen të theksohet se kjo bëhet vetëm pranë gjykatës së shkallës së parë e nga ana tjetër dispozita e nenit 47 nuk është dispozitë interaktive po është e drejtë diskrecionale e gjykatës të vlerësojë se me çfarë dënimi do të arrihet qëllimi i dënimit konform dispozitës së nenit 41 të KPK, me ç'rast gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë analizimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese me rastin e shqiptimit të dënimit.

Në të kundërtën, dispozita e nenit 385 të KPPK-së në mënyrë taksative parasheh rastet kur një vendim gjyqësor konsiderohet se është i përfshirë me këto shkelje ndërsa në rastin konkret nuk precizohet se për cilat shkelje tjera bëhet fjalë. Vlen të theksohet se cilësimi juridik i veprës penale është rezultat i vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike për çka pretendimet se është shkelur Ligji penal në dëm të të dënuarit, është qartazi i pabazë.

Nga arsyet e lartcekura e konform dispozitës së nenit 437 të KPPK-së, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit është refuzuar si e pabazë dhe është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

PML.nr.34/2016 datë 29 shkurt 2016

Procesmbajtëse,
Qefsere Berisha

Kryetare e kolegjit
Emine Mustafa